

**Proçedura e kalimit, rrugët
e shkollimit & zgjedhja e
profesionit**

Informacione për prindërit

*Elterninformation Übertrittsverfahren
Bildungswege & Berufswahl
Albanisch*

Proçedura e kalimit, rrugët e shkollimit dhe zgjedhja e profesionit

Mbas klasës së 6. fillore vendosen për herë të parë drejtimet për të ardhmen profesionale të fëmijës. Prindërit dhe mësuesit vendosin së bashku në proçedurën e kalimit, se cila është për më tutje oferta shkollore e përshtatshme për fëmijën. Sistemi shkollor zviceran iu ofron të rinjve edhe më vonë gjithnjë shanset për të zgjedhur shkolla të tjera për karrierën e tyre profesionale.

1. Proçedura e kalimit

Në proçedurën e kalimit bëhet një seleksionim. Sipas mundësive për rezultate të fëmijës mësuesi dhe prindërit zgjedhin ofertën shkollore të përshtatshme. Kjo është ose shkolla sekondare niveli A deri C ose gjimnazi kohëgjatë. Nga shkolla sekondare niveli A është më vonë edhe një herë i mundshëm kalimi në gjimnaz.

Mbrëmje informacioni

Në klasën e 5. dhe të 6. zhvillohen mbrëmje me prindër: Mësuesi informon mbi ecurinë e proçedurës së kalimit. Pjesëmarrja e prindërve është shumë e rëndësishme.

Bisedat e vlerësimit

Në klasën e 5. (në qershor) dhe në klasën e 6. (që nga shkurti) prindërit ftohen në një bisedë vlerësimi. Ata bisedojnë me mësuesin mbi rezultatet shkollore, notat, sjelljen dhe zhvillimin e mundshëm të fëmijës. Bisedat janë të detyrueshme.

Për prindërit ekziston një ndihmë për vëzhgimin. Me anë të kësaj ju mund të përgatiteni për bisedat.

[Dokument për parapërgatitjen për bisedë](#)

Vendimi i përbashkët

Në bisedën vlerësuese në klasën e 6. prindërit dhe mësuesi vendosin mbi tipin shkollor të ciklit sekondar I. Prindërit nënshkruajnë, se vendimi është marrë së bashku.

Mospajtim mendimesh

Në rast se mësuesi dhe prindërit nuk janë të një mendimi, atëherë zhvillohet një bisedë e dytë. Prindërit mund të marrin pranë vetes një person për këshillim. Në rast se mendimet mbesin të ndryshme, atëherë prindërve iu jepet dosja e kalimit. Me anë të kësaj ata mundën brenda 10 ditësh të bëjnë kërkesën për pranimin e fëmijës në shkollën e dëshiruar. Drejtoria e shkollës merr vendimin mbi pranimin. Prindërit kanë pas kësaj mundësinë të paraqesin ankesë pranë Departamentit të arsimit dhe kulturës.

2. Përkrahje në zgjedhjen e profesionit

Pas procedurës së kalimit të rinjtë ndjekin shkollën sekondare 3-vjeçare ose gjimnazin kohëgjatë. Ky i fundit zgjatë 6 vite.

Shkolla sekondare

Shkolla sekondare zgjatë 3 vite. Me procedurën e kalimit i është caktuar fëmijës një nivel rezultatesh:

- Niveli A, për kërkesa më të larta
- Niveli B, për kërkesa të zgjeruara
- Niveli C, për kërkesa themelore

Sipas rezultateve fëmija mund ta ndërrojë nivelin.

Në shkollën sekondare të rinjtë shqyrtojnë mundësitë e tyre profesionale. Ata gjejnë përkrahje në zgjedhjen e profesionit. Ata vendosin për një mësim profesioni (Berufslehre), për një shkollë të mesme profesionale ose ata futen në gjimnazin kohëshkurtër.

Gjimnazi kohëshkurtër

Të rinjtë nga niveli A munden, kur kanë rezultate të mira, të kalojnë pas vitit të 2. të shkollës sekondare në gjimnazin kohëshkurtër dhe pas 4 viteve të bëjnë maturën. Edhe për këtë kalim ka një procedurë të veçantë. Të rinjtë paraqiten për këtë tek mësuesi kujdestar në gusht menjëherë në fillim të vitit të 2. të shkollës sekondare.

3. Rrugët e shkollimit

Zhvillimi i të rinjve rrjedh në mënyra të ndryshme. Shpesh interesi dhe motivimi për një qëllim profesional më të lartë shfaqen më vonë. Sistemi shkollor zviceran është shumë i depërtueshëm dhe ofron mundësi të ndryshme për të arritur qëllimet profesionale. Veçanërisht mësimi i profesionit (Berufslehre) ofron mundësi të ndryshme të shkollimit deri tek shkollat e larta profesionale.

Rrugët e shkollimit janë paraqitur në një grafik:
www.volksschulbildung.lu.ch/r/schulsystem

4. Kontakte për prindërit

Persona kontakti për prindërit janë mësuesit kujdestarë dhe drejtorja e shkollës.

FABIA

Qendra për këshillimin dhe integrimin e të huajve (FABIA) është një qendër e specializuar e pavarur. Ajo është në dispozicion të prindërve që flasin gjuhë të tjera pa pagesë në rastet e pyetjeve, vështirësive dhe konflikteve.

www.fabialuzern.ch



Bildungs- und Kulturdepartement
Dienststelle Volksschulbildung
Kellerstrasse 10
6002 Luzern

www.volksschulbildung.lu.ch
2016-1446/278246

Mars 2020